



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 11, paragrafi 4 i Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 35/17, dhjetor 2012), dhe të nenit 34, paragrafi 34.1 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të datës 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 18.05.2016, merr këtë

**VENDIM**

**Neni 1**

Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronave të paluajtshme në pronësi të Komunës, me pronat e paluajtshme të planifikuara për interes publik, në pronësi të Ismet Gashit.

**Neni 2**

Me këtë vendim lejohet këmbimi i:

1. pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës, pjesë e parcelave nr. 10013-1, 2996-0, Zona kadastrale Prishtinë, 685-3, 685-9, Zona kadastrale Matiçan, me
2. pronën e paluajtshme, në pronësi të Ismet Gashit, përkatësisht pjesë e parcelave nr. 685-2, 685-4, 685-5, 685-8, Zona kadastrale Matiçan.

**Neni 3**

Para shpalljes publike të vendimit, Komuna do të sigurojë vlerësimin e kualifikuar e të pavarur të vlerës së tregut të secilës pronë komunale dhe pronës në pronësi të personave fizikë.

**Neni 4**

Këmbimi i cekur në pikën II të këtij vendimi, do të publikohet në ueb-faqen e Komunës dhe tabelën e shpalljeve me të dhënat e pronave të këmbyerë, vlerën e tyre, si dhe emrin e pronarit me të cilin është bërë këmbimi.

**Neni 5**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Financave dhe Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit.

**Neni 6**

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**  
01. nr. 035-121638 , më 19.05.2016



**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Halim Halimi, jur. i dipl.